



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

ZL.Anr.446/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kushtrim Neziri kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.476/2017 e datës 23.10.2017 e Kushtrim Neziri kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Kushtrim Neziri kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë me të cilën pretendon se në këto vendvotime mungojnë votat në Formularët e Rezultateve Përfundimtare FRP si: në Shkollën Filllore “Mihal Grameno” QV 0901X dhe në Shkollën Filllore “Selman Riza” QV 0901e përkatësisht në këto VV 0901x/01R, 0901x/2R, 0901x/3R, 0901x/4R, 0901x/05R, 0901x/06R, 0901x/07R, 0901x/08R, 0901x/09R si dhe VV 0901e/04R, 0901e/05R, 0901E/06R, 0901E/07R, 0901E/08R, 0901E/09R, 0901E/10R, 0901E/11R, 0901E/12R dhe 0901E/14R. Si dëshmi ankesës i ka bashkangjitur kopjet e FRP-ve të këtyre qendrave të votimit.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi

shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 446/2017 me datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Paneli
Zyhdi Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-